



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:098758
Datë: 21.08.2024
Numri i dokumentit: 06069836

C.nr.2207/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëseve M.E.G., K.B.N., F.H., R.Gj.S., A.H. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokat Rr.H., me seli në Prishtinë, ndaj të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e Inflacionit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 21.08.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit për shkak të inflacionit për periudhën kohore nga 21.05.2018 e deri me datë 21.11.2022, (për 54 muaj), paditësve tua paguajë shumat si në vijim:
- a. Paditëses M.E.G. ne emër të kompensimit për përqindjen në inflacion, për periudhën 21.05.2018 e deri me datë 21.11.2022 (per 54 muaj), t'ia paguajë shumën prej 824.19 Euro,
 - b. Paditëses K.B.N. ne emër të kompensimit për përqindjen në inflacion, për periudhën 21.05.2018 e deri me datë 21.11.2022 (per 54 muaj), t'ia paguajë shumën prej 824.19 Euro,
 - c. Paditëses F.H. ne emër të kompensimit për përqindjen në inflacion, për periudhën 21.05.2018 e deri me datë 21.11.2022 (per 54 muaj), t'ia paguajë shumën prej 550.39 Euro,
 - d. Paditëses R.Gj.S. ne emër të kompensimit për përqindjen në inflacion, për periudhën 21.05.2018 e deri me datë 21.11.2022 (per 54 muaj), t'ia paguajë shumën prej 704.13 Euro,

- e. Padi tëses A.H. ne emër të kompensimit për përqindjen në inflacion, për periudhën 21.05.2018 e deri me datë 21.11.2022 (per 54 muaj), t'ia paguajë shumën prej 704.13 Euro,
- II. DETYROHET e paditura që paditësve shumat si në pikën I tua paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga dita e parashtimit të padisë me datë 18.05.2022, e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto brenda afatit prej shtatë ditëve kalendarike, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 352.00 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarit së tyre, pranë kësaj gjykate me datën 18.05.2022, ka parashtuar padi ndaj të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e Inflacionit. Në padi ndër tjera theksohet se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, me Kontratë pune, se të njëjtëve ju takon kompensimi për shtesat ne pagë nga baza e Inflacionit. Tutje me parashtesën për precizimin e padisë i autorizuari i të paditësve ka kërkuar nga gjykata qe te detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit që ne emër te pagesës se përqindjes se inflacionit te paguaj paditëseve shumen e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, te gjitha me kamate 8% nga data e paraqitjes se padisë e deri ne pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të pranuar në Gjykatë me dt.05.09.2022, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sepse paditëset nuk kanë ofruar prova se i ka shterur te gjitha mjetet juridike ne procedure administrative para se ti drejtohet gjykatës me padi, tutje ka shtuar se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar. Gjykata i ka dorëzuar te paditurës precizimin e kërkesëpadisë se datës 26.03.2024.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor mbi aprovimin e kërkesëpadisë pa caktuar fare seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës nga neni 398 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Gjykata ka vlerësuar provat e bashkëngjitura me padi dhe atë: Kontrata e punës për paditësen M.G, te datës 01.09.2009, me nr.protokolli. 60, Kontrata e punës për paditësen K.B., te datës 01.10.2012, me nr.protokolli. 63, Kontrata e punës për paditësen F.H., te datës 01.03.2003, me nr.protokolli. 23, Kontrata e punës për paditësen R.Gj., te datës 01.11.2005, me nr.protokolli. 40, Kontrata e punës për paditësit A.H., te datës 01.10.2012, me nr.protokolli. 66, si dhe Listat e pagave.

Nga provat e bashkëngjitura në padi, Gjykatës i rezulton se paditësja M.E.G. është në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës “Pedagoge” në IP “FATOSAT” në Prishtinë, paditësja K.B. është në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës “Edukatore” në IP “FATOSAT” në Prishtinë, paditësja F.H. është në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës “Punëtore Teknike” në IP “FATOSAT” në Prishtinë, paditësja R.Gj. është në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës “Motër Edukatore” në IP “FATOSAT” në Prishtinë, dhe paditësja A.H. është në marrëdhënie pune me të paditurën, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës “Motër Edukatore” në IP “FATOSAT” në Prishtinë. Nga lista e pagave nga buxheti i Republikës së Kosovës rezulton se paga bazë për secilën paditëse veç e veç. Provave materiale të lartë cekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimine autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkuara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila kanë hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe kontratës kolektive te dt. 21.01.2021 Kjo për faktin se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e përqindjes se inflacionit i referohen periudhës nga janar muaji maj 2018 deri ne dhjetor 2022 periudhë kjo e cila ka qenë e rregulluar dhe gjen mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi nga dt.18.04.2017 dhe dt.21.01.2021.

Çështja e kompensimit të inflacionit në pagë, parashihet me dispozitën nga neni 35, paragrafi 10, të Kontratave të lartë cituara Kolektive, në të cilën dispozitë është përcaktuar se: *10. Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.* Sipas kësaj dispozite, rezulton se e paditura sipas Kontratave Kolektive të lartë cituara, ka për obligim që paditësve t’ua paguajë shtesën e inflacionit për çdo muaj nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive të vitit 2017, ndërsa fakti se e paditura nuk i ka paguar kompensimin e shtesës së inflacionit në pagë paditëses është pohuar edhe nga vet pala e paditur në përgjigje në padi.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësit janë legjitimuar të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e

detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë gjykata vendosi duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjegjësisht në përgjigjen zyrtare të kësaj Agjencie, sipas të cilës përgjigje vërtetohet se në vitin 2018 shkalla e inflacionit ishte 1,1%, në vitin 2019 shkalla e inflacionit ishte 2,7%, në vitin 2020, shkalla e inflacionit ishte 0,2%, në vitin 2021 shkalla e inflacionit ishte 3,4%.

Bazuar në këto shkallë të inflacionit, është bërë edhe përlllogaritja me pagën bazë të paditëses, ashtu që paga bazë e paditëseve M.E.G. dhe K.B.N. prej 393.00 euro është llogaritur me shkallën/përqindjen e inflacionit për çdo vit, sipas kalkulimit si në vijim: Për vitin 2018, paga bazë 393.00×7 muaj = 2,751. x 1.10% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2018 është 30.26 euro. Për vitin 2019, paga bazë 393.00×12 muaj = 4,716.00 x 2.70% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2019 është 127.33 euro. Për vitin 2020, paga bazë 393.00×12 muaj = 4,716.00 x 0.20% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2020 është 9.43 euro. Për vitin 2021, paga bazë 393.00×12 muaj = 4,716.00 x 3.4% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2021 është 160.27 euro. Për vitin 2022, paga bazë 393.00×11 muaj = 4,323.00 x 11.5% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2022 është 497.14 euro. Pra në total shuma që i takon paditësve M.E.G. dhe K.B.N. nga baza e inflacionit në pagë, është shuma prej 824.19 € secilës paditëse veç e veç.

Ndërsa paditëses F.H. bazuar në pagën bazë prej 262.38 Euro është llogaritur me shkallën/përqindjen e inflacionit për çdo vit, sipas kalkulimit si në vijim: Për vitin 2018, paga bazë 262.38×7 muaj = 1,836.66 x 1.10% (inflacion) shuma që i takon paditëses për vitin 2018 është 20.20 euro. Për vitin 2019, paga bazë 262.38×12 muaj = 3,148.56 x 2.70% (inflacion) shuma që i takon paditëses për vitin 2019 është 85.01 euro. Për vitin 2020, paga bazë 262.38×12 muaj = 3,148.56 x 0.20% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2020 është 6.29 euro. Për vitin 2021, paga bazë 262.38×12 muaj = 3,148.56 x 3.4% (inflacion) shuma që i takon paditëses për vitin 2021 është 107.05 euro, Për vitin 2022, paga bazë 262.38×11 muaj = 2,886.18 x 11.5% (inflacion) shuma që i takon paditëses për vitin 2022 është 331.91 euro. Pra në total shuma që i takon paditëses F.H. nga baza e inflacionit në pagë, është shuma prej 550.46 €.

Ndërsa paditëseve R.Gj.S. dhe A.H. bazuar në pagën bazë prej 335.63 Euro për secilën paditëse veç e veç është llogaritur me shkallën/përqindjen e inflacionit për çdo vit, sipas kalkulimit si në vijim: Për vitin 2018, paga bazë 335.63×7 muaj = 2,349.41 x 1.10% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2018 është 25.84 euro, Për vitin 2019, paga bazë 335.63×12 muaj = 4,027.56 x 2.70% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2019 është 108.74 euro. Për vitin 2020, paga bazë 335.63×12 muaj = 4,027.56 x 0.20% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2020 është 8.05 euro. Për vitin 2021, paga bazë 393.00×12 muaj = 4,027.56 x 3.4% (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2021 është 136.93 euro. Për

vitin 2022, paga bazë 335.63×11 muaj = $3,691.93 \times 11.5\%$ (inflacion) shuma që i takon paditëseve për vitin 2022 është 424.57 euro. Pra në total shuma që i takon paditësve M.E.G. dhe K.B.N. nga baza e inflacionit në pagë, është shuma prej 704.00 € secilës paditëse veç e veç.

Bazuar në këto konstatime, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, por të njëjtin e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohen pengesë që paditësit t'i realizojë të drejtat e garantuara me vendim të qeverisë dhe kontratë kolektive, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me kamatën ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht datë 29.03.2022, e deri në pagesën definitive.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme deri në këtë fazë të procedurës në vlerë të përgjithshme prej 352.00 Euro dhe atë: 312.00 Euro në emër të përpilimit të padisë dhe 40.00 Euro në emër ta taksës për padi. Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrit tarifor 6).

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 160 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.2207/2022, datë 21.08.2024

Gjyqtari,
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.